

There are no translations available.

Në kuadrin e zbatimit të programit të fushatës zgjedhore për Kongresin e 6të të BSPSH-së në Fier dhe Lushnje, më datën 27 qershor 2014 u mbledhën Konferenca e 6të e BSPSH –së Lushnje dhe Fier, me pjesëmarrjen e 35 delegatëve përfaqësues të 12 seksioneve profesionale të sindikatave të Rrethit Lushnje me një anetaresi prej 2772 anetare dhe me pjesëmarrje të 40 delegateve që përfaqësojnë 7 seksione profesionale të sindikatave të Rrethit Fier me një anetaresi prej 1453 anetaresh. Në Konferencat asistuan të deleguarit e Keshillit Kombëtar të BSPSH-së Presidenti i saj z. Gëzim Kalaja, z. Sami Kariqi Zv/ President i BSPSH, si dhe monitoruesi i konferencave zgjedhore Sekretari Organizativ Koço Jani, si dhe Drejtoresha e Departamentit Juridik Arjola Alike. Në emër të Këshillave Sindikale të BSPSH të rretheve mbi aktivitetin e organizatave u paraqitën raportet nga znj. Hatixhe Boriçi, Kryetare e BSP të Rrethit Lushnje dhe z. Shpetim Sina, Kryetar i BSP të Rrethit Fier.

Delegatet e Konferencave, u njohën me aktivitetet me të rëndësishme që janë zhvilluar që nga viti 2010 e në vazhdim. Drejtuesit e BSP të Lushnjes dhe Fierit në raportet e tyre u përqendruan në realizimin e objektivave si më poshtë: Në njohjen dhe zbatimin e vendimeve të Forumeve Qendrore të BSPSH nga të gjitha strukturat sindikale të profesioneve të cilat kanë gjallëruar aktivitetet organizative dhe kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kërkesave për një mbrojtje me efektive të anetaresive sindikale në çështjet me të rëndësishme social- ekonomike. Në bashkëpunimin me efektiv në kuadrin e dialogut social me punëdhënesin publik dhe privat, me zyrtarë vendore të punës, të cilat janë konkretizuar në praktike me lidhjen e 12 kontratave kolektive në nivel seksioni, që përfaqësojnë të gjithë anetaresin sindikale të Rrethit Lushnje si dhe me lidhjen e 7 kontratave kolektive të seksioneve profesionale të Rrethit Fier. Gjithashtu në raportet u përmenden shembujt faktikë të mbrojtjes së interesave kolektive të punonjësve në përgjithësi, siç ishte protesta e drejtuesve të autoveturave 8 + 1 ose në veçanti rastet e mbrojtjes së individëve siç ishin rastet e largimit nga puna të Kryetarit të Sindikes së Shëndetësisë, z. Ferdinand Zdrava dhe kryetares së Sindikates së Post- Telekomit Fier znj. Vaide Majaci.

Në raportet e paraqitura pati edhe kritika siç ishin rastet e mospagimit të kuotave sindikale nga disa struktura profesionale ku kryetarët e këshillave të rretheve perkatese ju bënë thirrje gjithë anetaresive, Këshillave Sindikale të ndermarrjeve që krahas detyrave për mbrojtjen e interesave social- ekonomike të angazhoheshin me shumë për detyrimet që kanë ndaj sindikates, siç është shlyerja e kontributeve sindikale.

Konferencat e BSP të rretheve Lushnje dhe Fier, u përshëndetën nga Presidenti i BSPSH z. Gëzim Kalaja ku midis të tjerave ai vlerësoi punën e mirë të Këshillave të Rretheve dhe në veçanti të drejtueses së Keshillit Sindikal të Lushnjes, znj. Hatixhe Boriçi. Presidenti i BSPSH kërkoj impenjim dhe gjallërim të mëtejshëm të strukturave sindikale të ndermarrjeve për të shtuar anetaresin sindikale me anetare të rinj si dhe rritje dhe forcim të ndjenjës së solidaritetit midis anetaresive sindikale në përgjithësi. Gjithashtu, z. Kalaja ju bëri prezent delegateve qëndrimet që ka mbajtur dhe mban BSPSH-ja ndaj marrëveshjes së qeverisë me FMN. Presidenti i BSPSH i njohu pjesëmarrësit e Konferencave me qëndrimet e BSPSH ndaj

reformes se pensioneve, duke theksuar mospranimin e ngritjes se moshes se daljes ne pension per burrat mbi 65 vjeç dhe grate mbi 63 vjeç. Ne fund Konferencat zgjedhore kaluan ne procedurat e votimit per zgjedhjen e drejtuesave te rinj te Keshillave sindikale te rretheve, si dhe te deklarimit te votave me mandate perfaqesimi per kandidatin per president te BSPSH. Procedurat u zbatuan ne menyre korrekte nga komisioni i votimit nen monitorimin e perfaqesuesve te Sekretariatit te Organizmit. Ne emer te Komisionit te Votimit te Konferences Zgjedhore te Lushnjes, Kryetari i Komisionit shpalli drejtuesin e ri te zgjedhur znj. Hatixhe Boriçi, ndersa Komisioni i Votimit i Konferences Zgjedhore Fier shpalli drejtuesin e ri te zgjedhur z. Shpetim Sina.

